



**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-04

**Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës**

**Vendosi:** Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, Kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 5 tetor 2023

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*

---

**Vendimi i Dytë mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Thirrjen e Dëshmitarit DW4-01  
sipas Rregullës 121(3) të Rregullores**

---

**Zyrës Administrative**

Administratores

Shefit të Zyrës për Mbrojtjen dhe

Mbështetjen e Dëshmitarëve

~~Reclassified as Confidential pursuant to instructions contained in CRSPD125 of 23 October 2023.~~

Reclassified as Public pursuant  
to instructions contained in  
CRSPD152 of 8 January 2024

**TRUPI GJYKUES I** (Trupi Gjykues) nxjerr këtë vendim të dytë në lidhje me kërkesën e Mbrojtjes sipas rregullës 121(3) të Rregullores për thirrjen e dëshmitarit DW4-01.

1. Më 29 shtator 2023, Trupi Gjykues nxori Vendimin mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Thirrjen e Dëshmitarit DW4-01 sipas Rregullës 121(3) të Rregullores ("Vendimi i Parë sipas Rregullës 121(3)"), me të cilin Trupi Gjykues thirri dëshmitarin DW4-01 për t'u paraqitur për të dëshmuar para Trupit Gjykues jo më herët se 6 tetor 2023, dhe urdhëroi Zyrën Administrative që t'ia dorëzonte fletëthirrjen dëshmitarit dhe të bënte organizimin e nevojshëm për dhënien e dëshmisë prej tij nëpërmjet videokonferencës.<sup>1</sup>

2. Më 3 tetor 2023, Zyra Administrative informoi Trupin Gjykues se organizimi i dhënies së dëshmisë prej DW4-01-shit më 6 tetor 2023 nëpërmjet videokonferencës dhe dërgimi paraprakisht i fletëthirrjes për këtë qëllim dëshmitarit nuk ishin të realizueshme pasi Zyra Administrative po mbështet aktualisht aktivitete të tjera të gjykatës dhe se ajo duhet gjithashtu të mbajë parasysh kushtin që vendi ku dëshmohet përmes videokonferencës duhet të jetë i favorshëm për dhënien e dëshmisë me vërtetësi dhe në mënyrë të hapur, duke garantuar sigurinë fizike, mirëqenien fizike, dinjitetin dhe privatësinë e dëshmitarit.<sup>2</sup> Megjithatë, Zyra Administrative vlerëson se është i mundshëm të bëhet organizimi i nevojshëm për dhënien e dëshmisë nga DW4-01 përmes videokonferencës më 25 tetor 2023 dhe në të gjitha datat e tjera alternative

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-04, F00674, Trupi Gjykues I, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Thirrjen e Dëshmitarit DW4-01 sipas Rregullës 121(3) të Rregullores*, 29 shtator 2023, konfidencial, para. 20-24, dhe Shtojca 1, konfidenciale.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-04, F00679, Zyra Administrative, *Parashtrime të Administratores në lidhje me Fletëthirrjen për të Dëshmuar nëpërmjet Videokonferencës* (Parashtrimet e Zyrës Administrative), 3 tetor 2023, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, para. 4.

~~Reclassified as Confidential pursuant to instructions contained in CRSPD125 of 23 October 2023.~~

Reclassified as Public pursuant to instructions contained in CRSPD152 of 8 January 2024

të identifikuara nga Trupi Gjykses në fletëthirrje dhe i kërkon leje Trupit Gjykses që të procedojë në këtë mënyrë.<sup>3</sup>

3. Duke pasur parasysh parashtrimet e Zyrës Administrative se organizimi i dhënies së dëshmisë së DW4-01-shit përmes videokonferencës më 6 tetor 2023 dhe dërgimi i fletëthirrjes dëshmitarit për këtë qëllim para asaj date, nuk janë të realizueshme, Trupi Gjykses, përmes këtij vendimi, lëshon fletëthirrjen e re për DW4-01-shin bashkëlidhur këtij vendimi dhe udhëzon Zyrën Administrative:

- (i) të bëjë organizimin e nevojshëm që DW4-01 të dëshmojë përmes videokonferencës nga e njëjta vendndodhje e identifikuar më parë në datat e specifikuara në fletëthirrjen bashkëlidhur;
- (ii) t'i dërgojë fletëthirrjen DW4-01-shit sa më shpejt që të jetë e realizueshme që ai të dëshmojë të mërkurën, më 25 tetor 2023; dhe
- (iii) ta informojë dhe t'i raportojë Trupit Gjykses në vijimësi jo më vonë se të hënën, 16 tetor 2023.

4. Udhëzimet që Trupi Gjykses ka dhënë më parë përmes Vendimit të Parë sipas Rregullës 121(3) mbeten në fuqi, përveç nëse ndryshohen dhe për aq sa ndryshohen nga ky vendim.

5. Së fundi, Trupi Gjykses udhëzon Zyrën Administrative të dorëzojë një version të redaktuar konfidencial të parashtrimeve të saj (parashtrimi i protokolluar F00679) sa më shpejt që të jetë e realizueshme pas kryerjes së aktiviteteve të tjera të lartpërmendura të gjykatës ose, nëse nuk ka nevojë për redaktime, të kërkojë riklasifikimin të parashtrimeve të saj. Nëse Zyra Administrative dëshiron t'i mbajë

---

<sup>3</sup> Parashtrimet e Zyrës Administrative, para. 5-6.

~~Reclassified as Confidential pursuant to instructions contained in CRSPD125 of 23 October 2023.~~

Reclassified as Public pursuant  
to instructions contained in  
CRSPD152 of 8 January 2024

parashtrimet e saj rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, ajo duhet ta informojë Trupin Gjykes për arsyet përkatëse.

6. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykes **URDHËRON** Zyrën Administrative të veprojë në përputhje me udhëzimet e Trupit Gjykes të përcaktuara në këtë vendim.

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Mapi Feld-Folia**  
**Kryegjykatëse**

/nënshkrimi/

**Gjykatës Zhilber Biti**

/nënshkrimi/

**Gjykatës Roland Dekers**

E enjte, 5 tetor 2023

Në Hagë, Holandë.